

RAPORT


I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e Studimit Master Profesional në: “Menaxhim Sigurimesh”


Ofruar nga Kolegji Universitar “Luarasi”

Ekspertët e Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Brunilda Duraj



Prof. Asoc. Gentiana Sharku



Janar / 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”

Ofruar nga Kolegji Universitar “Luarasi”

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Luarasi”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Ekonomik
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 512, datë 16.10.2017
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli i 7 (shtatë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2017 - 2018
16	Numri i Studentëve	41

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

Boni *Qly*

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”

Kolegji Universitar “Luarasi”, është një institucion jopublik i arsimit të lartë që ushtron aktivitet në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. KU “Luarasi” ka nisur ushtrimin e aktivitetit me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 611, datë 11.09.2003 “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike, “LUARASI.” Me vendim nr. 115, datë 15.12.2017, Bordi i Akreditimit, vendosi akreditimin institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, të Kolegjit Universitar “Luarasi” me kohëzgjatje 6 (gjashtë) vite akademike.

Kolegji Universitar “Luarasi” përbëhet nga tre Fakultete:

Fakulteti Ekonomik;

Fakulteti i Drejtësisë;

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit;

Fakulteti Ekonomik në Kolegjin Universitar “Luarasi” përbëhet nga tre Departamente:

Departamenti i Financë – Bankë;

Departamenti i Administrim Biznesit;

Departamenti i Ekonomiksit.

Departamenti i Administrim Biznesit është përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”.

Programi Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” është licensuar si program studimi i ciklit të dytë, me urdhër të MASR, Nr. 512, datë 16.10.2017. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”. Sipas pikës 2 të këtij urdhëri veprimtaria akademike për programin e studimit fillon në vitin akademik 2017 – 2018. Në mbështetje të nenit 14, 15, 103, 104, 106 të ligjit nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji Univesritar “Luarasi” kërkoi fillimin e procedurave të akreditimit për programin e studimit. Bazuar në nenin 62, pika 3 i LAL nr 9741, datë 21.02.2007 (sipas papashikimeve të nenit 136 i LAL 80/2015 ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit për programit Master Profesional në “Manaxhim Sigurimesh” nëpërmjet shërbimit AMS. Me shkresë nr. Prot. 46/2, ASCAL njoftoi institucionin se periudha e miratuar për zhvillimin e procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit të programit MP “Menaxhim Sigurimesh” është nëntor 2018 - prill 2019.

Me urdhër nr. 93, datë 31.10.2018 të ASCAL, pas dorëzimit të DVV nga institucioni, në datën 16.10.2018, ASCAL vendosi si ekspertë të jashtëm Prof. Asoc. Dr. Brunilda Duraj dhe Prof.Asoc. Dr. Gentiana Sharku. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) për realizimin e procesit të vlerësimit u mbështet në një seri dokumente dhe kriteresh në lidhje me standartet dhe mënyrën e funksionit të strukturave të ndryshme të KU “Luarasi”. Në datat 15 dhe 16 nëntor 2018, GVJ realizoi vizitat në ambientet e Kolegjit Universitar “Luarasi”. Gjatë vizitave në institucion GVJ zhvilloi takime me Rektorin, Dekanin, Përgjegjësin e Departamentit të Administrim Biznesit që është përgjegjës për programin në proces akreditimi, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore, zyrën e Kurrikulave, sekretarinë mësimore, studentë të programit përkatës dhe vëzhgoi ambiente të ndryshme në shërbim të procesit mësimor. Duke u mbështetur në informacionin e mbledhur gjatë vizitave në Institucion, në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në

dokumentacionin shtesë të kërkuar të vënë në dispozicion nga Institucioni, GVJ hartoi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e Masterit Profesional “Menaxhim Sigurimesh”.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Asoc. Dr. Brunilda Duraj

Prof. Asoc. Dr. Gentiana Sharku

GVJ është asistuar gjatë gjithë procedurës nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli.

Kolegji Universitar “Luarasi” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.12.2018, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 46/17 Prot, datë 17.12.2018. KU “Luarasi” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 215 Prot, date 28.12.2018 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

Për Komentin faqe 10, institucioni ka pranuar mosplotësimin e kriterit dhe ka marrë përsipër ta rregullojë për vitin akademik 2018-2019.

Për Komentin faqe 11, institucioni është dakord me komentin e GVJ ku raporti nuk mund të llogaritet, sepse personeli administriv punon në rang fakulteti dhe departamenti, jo sipas programeve të studimit.

Për Komentin faqe 16, komenti dhe arsyetimi i institucionit është i njëjtë me komentin e faqes 10.

Për Komentin faqe 17, institucioni ka pranuar mosplotësimin e kriterit duke dhënë edhe arsye të përkatëse dhe ka marrë përsipër ta rregullojë për vitin akademik 2018-2019.


Për Komentet faqe 19 dhe 20, GVJ konstatoi se biblioteka on-line nuk funksiononte në momentin e vizitës në institucion, por sipas Institucionit ajo është vënë në funksionim në nëntor të vitit 2018. GVJ i qëndron rekomandimit mbi pasurimin e bibliotekës, pasi literatura ekzistuese është e pamjaftueshme.

Për Komentin faqe 22, GVJ i qëndron konstatimit që ka bërë nga vizita me studentë në institucion. Sigurisht që anketimi nuk është plotësuar nga të gjithë studentët, por ata që ishin të pranishëm në takim pohuan se kanë plotësuar vetëm një herë pyetsorin on-line. Ky pohim vërtetohet edhe nga shënimet e mbajtura në institucion të paraqitura në platformën e ASCAL-it.

Për Komentin faqe 28, GVJ nuk ka mundur të gjykojë mbi cilësinë e përmbajtjes së syllabusve sepse syllabuset përmbanin vetëm temat, disa prej të cilave gjenden në syllabuset e disa lëndëve. Gjithsesi GVJ i qëndron komentit që ka bërë mbi literaturën, e cila përbëhet kryesisht nga leksione të pedagogëve në ppt.

Për Komentin faqe 32, institucioni ka pranuar mosfunksionimin e faqes së web-it, dhe ka marrë masat për rregullimin dhe përditësimin e saj.

Për Komentin faqe 32 – standardi II.8 – jemi dakord me GVB, por duke vlerësuar dokumentet e dërguara, vumë re se mungontë në rregulloren e diplomimit vetëm ky PS.



Për Komentin faqe 33, institucioni ka pranuar mosfunksionimin e faqes së web-it, dhe ka marrë masat për rregullimin dhe përditësimin e saj.

Për Komentet faqe 34, 35 dhe 37, GVJ i është referuar Dokumentit nr. 13 të paraqitur në dokumentacionin e DVV të vënë në dispozicion në platformën e ASCAL-it (on-line). Gjithsesi nga vizita në institucion GVJ nuk iu paraqit ndonjë program specifik për njohuritë shtesë që studentët e pranuar të kenë marrë përpara se të pranoreshin në këtë PS. GVJ bie dakord me komentin e bërë nga institucioni.

Për Komentin faqe 40, GVJ i është referuar kontrollit të faqes zyrtare të institucionit gjatë kohës që ka bërë vlerësimin.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” është konceptuar në harmoni të plotë me vizionin dhe misionin e përgjithshëm të Kolegjit Universitar “Luarasi” si dhe zhvillimeve dhe ndryshimeve ekonomiko-shoqërore të vendit, nevojave të mëdha që dikton situata aktuale për drejtues të kualifikuar në fushën e sigurimeve, si dhe në kuadër të zhvillimeve të vrullshme të teknologjisë, e cila dikton nga ana e saj kërkesa të reja për të menaxhuar më mirë inovacionet dhe modelet e reja të sigurimeve. Vizioni i Kolegjit Universitar “Luarasi” është: Arsim cilësor - dije të qëndrueshme - kërkimim shkencor dhe inovacion. Pra vizioni i tij është të zerë vend elitare në vendin tonë në fushën e arsimit, kërkimit dhe zhvillimit, duke qënë në shërbim të plotë të shoqërisë. Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe kuadrit të Akreditimit Institucional, Kolegji Universitar “Luarasi” ka hartuar Planin Strategjik 2016 – 2020.

Misioni i programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” është ndërthurja e tre komponentëve;

- Ofrimin e mësimdhënies me cilësi të lartë duke përfshirë edhe ekspertët më të mirë në fushën e sigurimeve në vendin tone;
- Udhëheqjen në kërkime akademike në fushën e sigurimeve;
- Sigurimi i një shërbimi profesional në fushën e sigurimeve që do t’i shërbejë menaxhimit më të mirë të portofoleve të sigurimit të individëve dhe kompanive, në një treg gj gjithmonë në rritje.

Ky mision ofron mundësi të mëdha arsimore përmes metodave efektive të arsimit, të kurrikulave përkatëse dhe të këshillimit akademik; angazhimin në aktivitete që ndihmon në rritjen e arsimit profesional. Përcimi tek studentët i njohurive të thelluara në fushën e sigurimeve, i pajis ata me dije, që u japin mundësinë për të vazhduar studime të thelluara në disiplina të tjera, të jenë të aftë për të zbatuar me sukses strategji dhe politika në zhvillimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri; aftësimi i tyre për të dizenuar dhe menaxhuar me sukses produktet e sigurimeve në tregjet financiare për individët ashtu edhe për kompanitë, marrja e dijeve bashkëkohore jo vetëm në fushën e sigurimeve por edhe e dijeve të qëndrueshme në fusha të tjera si aktuaristika, risigurimi, menaxhimi i risqeve financiare, duke ndikuar në menaxhimin e kapaciteteve në të gjitha. **(Sipas planit strategjik, rregullores së PS)**

Objektivat e Programit: Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” janë:

1. Formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë në aspektin teorik dhe praktik;
2. Pajisja e tyre me koncepte moderne teorike dhe praktike në fushën e sigurimit të pronës, sigurimit të jetës, pensionet private, sigurimi i mjeteve motorike, etj
3. Integrimi i teorisë dhe praktikës ndërkombëtre si dhe integrimin e eksperiencës shqiptare në fushën e menaxhimit të sigurimeve dhe risigurimeve në fushat e mësipërme duke patur në vëmendje kërkesat e reja që pasqyrojnë tregjet e vecanta, brenda cdo sistemi sigurimesh.
4. Përafrimi me standardet Europiane dhe më gjerë në zbatimin e mekanizave dhe formave të organizimit të tregut të sigurimeve, kryesisht në procesin e integrujes drejt BE-së.
5. Përgatija e specialistëve në nivelin drejtues në fushën e sigurimeve sipas fushave respective

Kolegji Universitar “Luarasi” ofron studime në fushën e ekonomiksit në dy ciklet e studimit (bachelor dhe master), të cilat drejtohen nga departamenti i Administrim biznesit.

Misioni i Departamentit të Administrim Biznesit është përgatitja e individëve të kualifikuar, që mund të shërbejnë në sektorin privat, publik dhe në organizata jo fitimprurëse, duke siguruar një arsimim të gjerë profesional. Ai e realizon këtë duke ndërthurur mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe praktikat profesionale.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Gjate shqyrtimit të dosjes së vetvlerësimit si dhe strategjisë së Institucionit, misioni i programit të studimit përputhet me qëllimet dhe misionin e Institucionit. PS materializon objektivat strategjike të IAL në fushën e Edukimit, kërkimit dhe formimit profesional. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Ky program është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët më të mirë në fushën e sigurimeve në vendin tonë, duke reflektuar nevojat reale të tregut të sigurimeve.</p> <p>Ai i përgjigjet kërkesës për përgatitjen e menaxherëve që do të jenë të aftë të punojnë në tregjet financiare dhe atë të sigurimeve, një specializim që kërkohet kryesisht nga kompanitë që operojnë në tregun e sigurimeve, por edhe nga autoritetet mbikqyrëse si AMF, etj. Për kërë GVJ kërkoi raportin e studimit të tregut të punës.</p> <p>Programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit, nevojat për përgatitjen e specialistëve të aftë për të punuar për zhvillimin e politikave ekonomike. Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Në programin që vlerësohet kjo</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	realizohet përmes përfshirjes në programin e studimit të moduleve me zgjedhje që trajtojnë problematikat që lidhen me tregjet financiare dhe atë të sigurimeve, Aktuaristikën, Menaxhimin dhe Drejtimin e Biznesit në sigurime.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Sipas RVB, dokumentacionit të programit dhe takimit me titullarët, u konstatua që PS është përshtatur dhe zhvilluar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IAL.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Sipas RVB-së, dokumentacionit të programit të paraqitur në ASCAL, u konstatua që PS është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Programi Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” është licensuar si program studimi i ciklit të dytë, me urdhër të MASR, nr. 512, datë 16.10.2017. Për këtë program studimi, është hartuar dhe rregullorja përkatëse. Shqyrtimi i Rregullores së PS vërtetoi se emërtimi është në përputhje me KSHK, niveli 7, “Master profesional”, ku pasi i pajis studentët me njohuri të thelluara profesionale, e përmbyll formimin ose me punim diplome ose me provim përfundimtar. Diploma e lëshuar sipas nivelit 7 të KSHK-së është “Master profesional”
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Sipas dokumentacionit (vendimit të Senatit Akademik nr 12/3, datë 23.12.2016), por edhe vizitave në Kolegjin Universitar “Luarasi”, GVJ u njoh me Planin Strategjik të zhvillimit 2016-2020. Në planin strategjik meren në konsideratë zhvillimet e vazhdueshme të tregut të punës, që con dhe në konkurrencë më intensive dhe parashikohen përmirësime të programeve të studimit në përputhje me zhvillimet që kërkon tregu, duke garantuar cilësinë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Si pjesë e planit Strategjik 2016-2020, Kolegji Universitar “Luarasi” është duke përmirësuar Strategjinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, në mënyrë që të garantohet zhvillimi i aftësive të mendimit kritik, të nxisë kërkimin shkencor dhe inovacionin, të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që ka menaxhimi efektiv i ekonomisë për shoqërinë, për të qenë të suksesshëm në punësim në tregun vendas apo edhe atë të huaj.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe objektivat e përcaktuar në statutin e institucionit.
2. Programi i studimit master professional në “Menaxhim sigurimesh” përputhet me strategjinë për zhvillim të Institucionit dhe është hartuar në përputhje me strategjinë afatmesme për zhvillimin e tij.
3. Në hartimin dhe zbatimin e këtij Programi janë mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe parakushteve të rrjedhura nga Ligji i Arsimit të lartë dhe Udhëzimet përkatëse të MAS.
4. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimet përkatëse të MAS.

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura akademike dhe organizative e Kolegjit Universitar Luarasi është e përcaktuar qartë në Statutin dhe rregulloren e Kolegjit Universitar Luarasi, hartuar në bazë të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të tij.

Struktura akademike për periudhën 2017 – 2018 përbëhet nga dy njësi kryesore:

Fakulteti i Ekonomisë;

Fakulteti i Drejtësisë;

Me urdhër të MASR Nr. 266, datë 14.05.2018, hapet Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit me përbërjen:

Departamenti i Informatikës Ekonomike

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit

Departamenti i Matematikës dhe Statistikës

Sipas pikës 2 të këtij urdhëri veprimtaria akademike e këtij fakulteti fillon në vitin akademik 2018 - 2019.

Programi i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Menaxhim Sigurimesh është hapur në vitin akademik 2017-2018, në bazë të urdhërit të MASR nr. 512, datë 16.10.2017. Ky program përmban 60 kredite, realizohet në gjuhën shqipe dhe zgjat një vit akademik (dy semestra).

Përgjegjës për programin Master Profesional në Menaxhim Sigurimesh është *Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Administrim-Biznesit.*

Fakulteti Ekonomik ka tre njësi bazë:

1. Departamenti Financë-Bankë
2. Departamenti Administrim-Biznesi
3. Departamenti i Ekonomiksit

Fakulteti Ekonomik është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore në fushën e studimeve në ekonomi, i cili ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në fushën ekonomike, të hapura dhe të akredituara në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve, për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësive bazë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Struktura dhe funksioni i njësive bazë janë përshtatur sipas statutit dhe rregulloreve të institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Organet drejtuese të Fakultetit Ekonomik janë Dekani, Zëvendës Dekani, Përgjegjësit e Departamenteve, si dhe Administratori i Njesisë Kryesore dhe Asambleja e Personelit Akademik. Kopetencat dhe detyrat e secilit organ drejtues janë përcaktuar qartë në Statutin dhe Rregulloren e Kolegjit Univesitar “Luarasi”.

Asambleja e personelit Akademik drejton aktivitetin mësimor dhe shkencor nëpërmjet dy komisioneve të përhershme:

1. Komisionit të programeve mësimore dhe zhvillimit të kurrikulave;
2. Komisionit të kërkimit dhe zhvillimit shkencor.

Fakulteti Ekonomik ofron dy programe të ciklit të parë (bachelor), dy programe të ciklit të dytë (master profesional) dhe dy programe të ciklit të dytë (master i shkencave).

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat.

Sipas RVB, secili departament ka në përbërje të tij 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët 3 janë me grada shkencore: Prof. Doktor, Prof. As., dhe “Doktor”.

Departamenti Financë-Bankë ka gjithsej **14 pedagogë** të angazhuar, **7 PAE** (nga të cilët një me titullin Prof. Asoc, dy me gradën Dr, dhe katër me Msc) dhe **7 PAK** (nga të cilët një me gradën Dr. dhe gjashtë me Msc);

Departamenti Administrim-Biznesi ka gjithsej **16 pedagogë** të angazhuar, **7 PAE** (tre me titullin Prof. Asoc. dhe katër me Msc) dhe **9 PAK** (nga të cilët dy me titullin Prof. Asoc., dy me gradën Dr. dhe pesë me Msc);

Departamenti i Ekonomiksit ka gjithsej **16 pedagogë** të angazhuar, **7 PAE** (nga të cilët një me titullin Prof. Asoc., dy me gradën Dr. dhe katër me Msc) dhe **9 PAK** (nga të cilët një me titullin Prof. Asoc., dy me gradën Dr. dhe gjashtë me Msc).

Pra gjithsej Fakulteti Ekonomik ka angazhuar **46 pedagogë** ku **21 PAE** dhe **25 PAK**.

Të dhënat për personelin akademik janë paraqitur në **Tabelën 1 në Aneks**.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Kolegji univesitar Luarasi është organizuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin e tij të përcaktuar në statutin e tij të

<p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>hartuar në bazë të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të tij.</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 Kolegji Universitar “Luarasi” përbëhet nga tre njësi kryesore;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti Ekonomik • Fakulteti i Drejtësisë • Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit <p>Fakulteti Ekonomik i cili është përgjegjës për realizimin e programit Master Profesional në Menaxhim Sigurimesh, përbëhet nga tre njësi bazë (Departamente):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Financë-Bankë 2. Departamenti Administrim-Biznesi 3. Departamenti i Ekonomiksit <p>Departamenti Administrim-Biznesi i cili është përgjegjës për programin Master Professional në “Menaxhim Sigurimesh”, ka gjithsej 16 pedagogë të angazhuar, nga të cilët 7 PAE (tre me titullin prof. Asoc. dhe katër me Msc) dhe 9 PAK (nga të cilët dy me titullin Prof. Asoc., dy me gradën Dr. dhe pesë me Msc).</p>
--	---

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Të tre Departamentet që janë pjesë përbërëse e Fakultetit Ekonomik kanë objektiva dhe mision të përcaktuar qartë në Statutin dhe Regulloren e Institucionit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti Ekonomik drejton të gjithë aktivitetin mësimor dhe shkencor të njësisë kryesore, punën për hartimin e planeve dhe programeve mësimore, të cikleve të ndryshme nga njësitë bazë, siguron miratimin dhe zbatimin e tyre, si dhe përmbush të gjitha detyrat dhe funksionet e tjera të përcaktuara në statutin e institucionit.</p> <p>Nga takimet në institucion me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit të Administrim-Biznesit dhe Përgjegjësen e Burimeve Njerëzore, rezultoi se për procesin e rekrutimit të personelit, përgjegjësi i departamentit bën propozimet tek dekani për vendet vankante, i cili përcakton kriteret, të cilat miratohen më pas nga Rektori. Vlerësimi i personelit akademik bëhet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni angazhohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për përmbushjen e misionit të tij.
2. Struktura akademike përbëhet nga tre njësi kryesore: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Fakulteti Ekonomik i cili është

përgjegjës për realizimin e programit Master Profesional në Menaxhim Sigurimesh, përbëhet nga tre njësi bazë

3. Njësitë e institucionit angazhohen drejtëpërdrejtë dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimit.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Pjesa përshkrimore

Personeli akademik dhe drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e IAL, këshillim për studentët, detyra administrative, në përputhje me detyrat e përcaktuara në statutin e Kolegjit Universitar "Luarasi" dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës, e cila bazohet në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë. Mësimdhënia në këtë PS mbulohet nga Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) dhe Personel Administrativ. Mësimdhënia mbulohet kryesisht nga pedagogë të Departamentit të Administrim Biznesit, ndërsa një pjesë e moduleve (kryesisht ato me zgjedhje) mbulohen nga pedagogë të Departamentit Financë-Bankë dhe të jashtëm.

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **16 pedagogë gjithsej**, nga të cilët **6** janë Personel Akademik Efektiv (PAE), **10** janë Personel Akademik me Kontratë (PAK). Për këtë program studimi ndihmon Personeli Administrativ (PA) i Departamentit. **(Sipas Tabelës Nr. 4 në Aneks)**

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik 2017 – 2018 ka qene **6/10**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program per vitin akademik është **6 / 16 = 38 %**.

GVJ evidentoi si problematikë mosplotësimin e këtij kriteri. Institucioni e njëjtte dhe pranonte mosplotësimin e këtij kriteri, por duke qenë një master profesional specifik në fushën e menaxhimit të sigurimeve, aktivizimi i ekspertëve më të mirë të fushës në industrinë e sigurimeve si lektorë të jashtëm, do të realizonte më mirë qëllimin këtij PS, që synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktikat më të mira të industrisë së sigurimeve për të qenë të suksesshëm në këtë fushë sfiduese, shumë të nevojshme dhe të dobishme për zhvillimin e vendit.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Nga 16 pedagogë dhe punonjës kërkimor, 9 ose 56 % janë me tituj dhe grada.

Raporti PAE/PAK në këtë program është $6/10 = 0.6$

Raporti Personel Akademik/Personel Administrativ = nuk ka personel administrativ për këtë master

Raporti Personel Akademik./Student $16/41 = 0.39$ (një përsoneel akademik për cdo tre studentë) kanë qenë 44 std, nga të cilët 3 janë larguar.

Raporti Personel Administrativ/Student – nuk ka të dhëna për këtë program studimi, por ato mbështeten me stafin administrativ te departamentit të Administrim Biznesit, pasi numri i studentëve të këtij PS është i vogël - 41 studentë.

Të dhëna sipas seksit

Raportet gjinore nuk janë të balancuara në radhët e personelit akademik të departamentit të Administrim Biznesit.

Raporti M/F në Personelin Akademik Efektiv është 4/2, ndërsa për Personelin Akademik me Kontratë 6/4. Në total raporti M/F është 10/6.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Referuar RVB, PAE dhe PAK përbëhet nga disa grup moshë, 1 është në grup moshën 25-30 vjeç (PAK), 4 PAE dhe 1PAK janë në grupmoshën 36-45 vjeç dhe 1 PAE dhe 2 PAK në grupmoshën 46-55 vjeç, dhe 1 PAE dhe 1 PAK në grupmoshën 56-65 vjeç.

Përbërja e stafit sipas moshës mundëson harmonizimin e stafit me përvojë me stafin e ri dhe është një faktor i rëndësishëm për fuqizimin e njësisë.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në Kolegjin Universitar “Luarasi” procedura e rekrutimit bazohet në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, statutin dhe rregulloren e institucionit. Kolegji Universitar “Luarasi” ka kritere të shpallura për vlerësimin dhe rekrutimin e kandidatëve. Në kontratën individuale të punës janë të sanksionuara qartë të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësve dhe punëdhënësit, paga, sigurimet shoqërore dhe përfitimet e tjera, largimi nga puna, zgjidhja e kontratës, etj. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ kërkoi dokumentin e procedurës të rekrutimit të stafit akademik. Sipas dokumentit të vënë në dispozicion të GVJ, rekrutimi i stafit akademik bëhet nga grupi i ngritur ad-hoc me urdhër të dekanit të fakultetit dhe përbëhet nga rektori, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i burimeve njerëzore dhe administratori. Kriteret e rekrutimit përgatitëten në përputhje me vendet e lira të punës. Dekani propozon kriteret, të cilat miratohen me pas nga rektori. Njoftimi kalon në sekretari dhe më pas shpallet në website-in e institucionit, në rubrikën njoftime. Aplikimet dërgohen me email dhe dorazi pranë departamentit. Dekani urdhëron ngritjen e grupit ad-hoc me katër anëtarë, për shqyrtimin e aplikimeve. Për stafin akademik preferohen persona me tituj dhe grada shkencore dhe persona që kanë jo më pak se 2 vite eksperiencë në fushën e Sigurimeve. Marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratën individuale të punës, e cila nënshkruhet nga rektori i Universitetit dhe i punësuarit. Kontratat e punës variojnë nga disa mujore deri tek një vit. Dosjet e stafit akademik ndodhen pranë Departamentit të Burimeve njerëzore. Gjatë vizitës në institucion u kostatua që për të gjithë personelin akademik efektiv dhe me kontratë ka dosje të plota. Në stafin akademik të jashtëm mungonte leja nga punëdhënësi, por Institucioni argumentoi se Masteri në “Menaxhim Sigurimesh” ishte kryer më bashkëpunim me AMF dhe kompanitë më të mëdha të sigurimit në vend INSIG, EUROSIG. GVJ-së iu vendos në dispozicion marrëveshja e bashkëpunimit me këto institucione. Gjithashtu, gjatë vizitës në Institucion u vunë re disa mospërputhje në emrat e stafit akademik për programin e studimit sipas RVB si dhe emërtimit të një lënde. Institucionit iu kërkuar përditësimi i stafit akademik për programin e studimit si dhe vendosi në dispozicion të GVJ-së vendimin e dekanit, datë 15.11.2017 “Mbi ndryshimin semestral të modulit pa ndryshuar planin mësimor të MP “ Menaxhim sigurimesh” për vitin akademik 2017-2018.

Dosjet përmbanin gjithë dokumentacionin që kërkohet sipas Kodit të Punës.

Ndarja e ngarkesës mësimore bëhej në bazë të nenit 2/a, të Udhëzimit 20 mbi Ngarkesën Mësimore dhe zbatohet në përputhje me marrëveshjet e punës. Ngarkesa mësimore merrte në konsideratë detyrat akademike dhe administrative të personeli.

Për këtë PS lektorët kryejnë 2 ore leksioni në javë (për 15 javë) dhe pedagogu i seminarit kryente një ore seminari (15 javë).

Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitës në institucion

1. Formular aplikimi
2. Procedura e rekrutimit
3. Lista e stafit akademik per programin e studimit
4. Vendim për ndryshim lënde
5. Manuali i NJSBC
6. Raport vlerësimi i pedagogut
7. Marrëveshje bashkëpunimi
8. RVB.MP "Menaxhim sigurimesh", update tabela

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Në kontratat e punës dhe të shërbimit janë specifikuar përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të ofruar.</p> <p>Personeli akademik është angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. Nevojat e IAL për personel akademik me grada dhe tituj për këtë program studimi mbulohen nga PAE dhe PAK.</p> <p>IAL zbaton aktet Ligjore dhe nënligjore për ngarkesën mësimore. Shpërndarja e burimeve njerëzore midis njësive bazë të Fakultetit është bërë në përputhje me nevojat e Departamenteve si dhe duke mbajtur në konsideratë kualifikimin individual të stafit.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ gjatë vizitave në institucion, konstatoi se personeli akademik i brendshëm në bashkëpunim me ekspertët me të mirë në fushën e sigurimeve në vendin tonë si dhe duke iu përgjigjur kërkesave që ka tregu financiar dhe në vecanti ai i sigurimeve, në mungesë deri tani të një programi studimi të dedikuar dhe specializuar për fushën e industrisë së sigurimeve, si dhe interesit të treguar nga specialistë të fushës së sigurimeve, hartuan syllabuset e programit të studimi MP në “Menaxhim Sigurimesh”.</p> <p>Rekrutimi i stafit bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të IAL, dhe bazohet në procedura ligjore dhe transparente.</p> <p>Ndarja e ngarkesës mësimore bëhet në bazë të nenit 2/a, të Udhëzimit 20 mbi Ngarkesën Mësimore dhe zbatohet në përputhje me marrëveshjet e punës. Ngarkesa mësimore merret në konsideratë detyrat akademike dhe administrative të personelit.</p> <p>Zyra e Burimeve njerëzore kishte lista dhe dosje të plota të personelit me kohë të plotë. Tek dosja e PAK mungonte leja e titullarit të institucionit, por kjo lidhej me marrëveshjen e bashkëpunimit të IAL me kompanitë e sigurimit Sigal, Eurosig si dhe me Autoritetin e Mbikqyrjes financiare.</p> <p>Në mënyrë rastësore u përzgjedhën 2 emra, një PAE dhe 1 PAK dhe u verifikuan që dosjet përmbanin të gjithë dokumentacionin e duhur.</p>
--	---

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Në Kolegjin Universitar “Luarasi” procedura e rekrutimit bazohet në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë, statutin dhe rregulloren e institucionit. Kolegji Universitar “Luarasi” ka kritere të shpallura për vlerësimin dhe rekrutimin e kandidatëve. Në kontratën individuale të punës janë të sanksionuara qartë të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësve dhe punëdhënësit, paga, sigurimet shoqërore dhe përfitimet e tjera, largimi nga puna, zgjidhja e kontratës, etj. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ kërkoi dokumentin e procedurës e rekrutimit të stafit akademik. Sipas dokumentit të vënë në dispozicion të GVJ, rekrutimi i stafit akademik bëhet nga grupi i ngritur ad-hoc me urdhër të dekanit të fakultetit. Njoftimi shpallet dhe në website-in e institucionit. Për stafin akademik preferohen persona me tituj dhe grada shkencore dhe persona që kanë jo më pak se 2 vite eksperiencë në fushën e Sigurimeve. Zyra e</p>
---	---

Burimeve njërzore kishte lista dhe dosje të plota të personelit me kohë të plotë. Tek dosja e PAK mungonte vetëm leja e titullarit të institucioni, por kjo vërtetohet nga marrëveshja e bashkëpunimit të IAL-së me kompanitë e sigurimit.

Një nga problematikat e ngritura gjatë vizitës së GVJ-së për këtë PS ishte raporti PAE/PAK i stafit të angazhuar në këtë program studimi, konkretisht; 6/10.

Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit MP në “Menaxhim Sigurimesh” përbën **38%** të personelit akademik në total,(6/16), ndërsa ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik efektiv(PAE) është në masën **61%**.

Institucioni e njihet dhe pranonte mosplotësimin e këtij kriteri, por duke qenë një master profesional specifik në fushën e menaxhimit të sigurimeve, aktivizimi i ekspertëve më të mirë të fushës në industrinë e sigurimeve si lektorë të jashtëm, do të realizohente më mirë qëllimin këtij PS, që synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktikat më të mira të industrisë së sigurimeve për të qenë të suksesshëm në këtë fushë sfiduese, shumë të nevojshme dhe të dobishme për zhvillimin e vendit.

Nga takimi me Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë u informuam që vlerësimi i personelit akademik kryhet në disa mënyra:

- vlerësimi nga studentët;
- vlerësimi nga përgjegjësi i Departamentit
- vlerësimi nga drejtuesit e IAL.

Për secilën nga format kishte procedura të përcaktuara në manualin e NJSBC-së. GVJ kërkoi një raport vlerësimi nëpërmjet vëzhgimit, që vërteton procedurat e vlerësimit. IAL ka së fundi dhe versionin online për vlerësimin e personelit akademik. Vlerësimet e stafit u bëhen të ditura palëve të interesuara. Zyra e Burimeve Njerëzore kishte një dosje të vecantë me njoftimet për punë apo kërkesat për staf akademik. Kolegji Universitar “Luarasi” kishte dhe databazën e tij, në të cilin ruheshin të gjitha aplikimet për një pozicion pune të caktuar.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Në Programin Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”, ofruar nga Kolegji Universitar “Luarasi”, titullarët e lëndëve kanë gradën shkencore Prof.Asoc.Dr, ose Dr, ose Master Shkencor dhe është në përputhje me nenin 58, pika 6 e “Ligjit të Arsimit të Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Kjo vihet re në planin mësimor të lidhura me lëndët, por edhe në syllabus-et e Lëndeve. Gjithashtu, kanë një përvojë profesionale së paku 5 vjeçare në profesionin në të cilën ofrohet ky PS.</p> <p>Në kolegjin universitar “Luarasi” Rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimit.</p> <p>Kurikula e PS, Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” parashikon praktikë profesionale, por nga 44 studentët e rregjistruar të këtij masteri 42 ishin aktualisht punonjës në kompani e sigurimi.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Në këtë PS janë rregjistruar 44 studentë, ku vetëm 16 prej tyre kanë shlyer të gjitha provimet. Studentët e këtij PS ishin të lirë të zgjidhnin provim apo tezë në përfundim të këtij masteri.</p> <p>Numri i vogël i studentëve në këtë PS plotëson kriterin e udhëheqjes së temave nga stafi akademik me të paktën titullin “Doktor”.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se numri maksimal i studentëve që udhëhiqte një pedagog ishte jo më shumë se 10 studentë.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit e tezave të diplomës zgjidhen nga pedagogë të angazhuar në këtë PS dhe nga tabela e planit mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës, spikatin emra të njohur akademikësh, me njohuri të thelluara teorike në fushën e sigurimeve dhe aftësi të spikatura kërkimore në përputhshmëri me fushën që do të hartohet teza e studimit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e</p>	

misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Kurrikula e PS nuk përmban orë laborator. Megjithatë, Kolegji Universitar “Luarasi” mbulon me personel mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore.</p> <p>Shpërndarja e burimeve njerëzore midis njësive bazë të Fakultetit është bërë në përputhje me nevojat e Departamenteve si dhe duke mbajtur në konsideratë kualifikimin individual të stafit.</p> <p>Për këtë program studimi nuk ka personel administrativ të posacëm, por nevojat mbulohen nga stafi administrativ i departamentit të Administrim biznesi.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ është i mendimit se ngarkesa mësimore realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe kontratës së lidhur me KU “Luarasi”. Gjatë takimit në institucion, GVJ u njoftua se personeli PAE zhvillonte orët e leksioneve dhe të Diplomës që në total janë 310 orë në auditor Duke iu referuar këtij informacioni dhe tabelës nr 13, rezulton se përqindja e ngarkesës në orë për këtë PS, për PAE është 310 orë / nga 510 orë = 61%.</p>
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Kolegji Universitar “Luarasi” ka të dhëna për personelin akademik të përfshirë në program të sistemuara në dosjen personale të cdo pedagogu, si dhe për personin përgjegjës për PS. Në fund të cdo viti dosjet përditësohen me angazhimin kërkimor-shkencor për të gjithë personelin akademik.</p> <p>Kolegji Universitar “Luarasi” për këtë PS dispononte një listë të plotë të stafit akademik, por mungonte personeli ndihmës mësimor shkencor dhe personeli administrativ në dispozicion të këtij PS. Gjatë vizitës në institucion u argumentua mosplotësimi i këtij kriteri për shkak të numrit të vogël të studentëve.</p> <p>IAL ka përcaktuar kriteret dhe procedura të qarta për rekrutimin e PA. IAL i publikon ato rregullisht në website, tek rubrika “njoftime“, kur lind nevoja për rekrutime të reja.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. 2. Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të 	

institucionit. Në kontratat e punës dhe të shërbimit janë specifikuar përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet në funksion të përmbushjes së objektivave të programit.

3. Kolegji Universitar “Luarasi” ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. Kolegji Universitar “Luarasi” ka një zyrë të burimeve njëzore, e cila merret me politikën e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit dhe ruan të gjitha të dhënat për personelin. Procedurat e ndjekura për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit janë ligjore dhe transparente.
4. Nuk plotësohet kriteri mbi personelin akademi efektiv, që përbën së paku 70%. të personelit akademik të angazhuar në këtë program. Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit MP në “Menaxhim Sigurimesh” përbën **38%** të personelit akademik në total, (6/16), ndërsa ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik efektiv (PAE) është në masën **61%**.
5. Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.
6. Studentët që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.
7. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.
8. IAL disponon një bazë të dhënash për stafin akademik.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Kolegji Universitar “Luarasi” ushtron veprimtarinë e tij në një godinë të vetme në Rrugën e “Elbasanit”, nr. 59, H.1, Kodi Postar 1010, në Tiranë. Godina ka një sipërfaqe 3787 m² dhe në të janë të lokalizuara sallat e leksioneve dhe të seminareve, laboratorët, biblioteka, sekretaria mësimore, zyrat për personelin, dekanin dhe zv/dekanin.

Gjatë vizitës në KU “Luarasi” u vizituan disa ambiente si: salla leksionesh dhe seminaresh, biblioteka, laborator i informatikës etj. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin komode, të pajisura me tabela për të shkruar, projektor dhe kompjuter, si dhe mobilimi me tavolina dhe karrike për një zhvillim normal të procesit mësimor. Sallat kanë kushte të përshtatshme ndricimi. Në KU “Luarasi” ndodhet një bibliotekë, e cila sipas RVB ka një kapacitet prej 72 studentësh, një kompjuter për përdorim nga administrata, 11 kompjutera për përdorim nga studentët, një printer, tavolina leximi dhe një tavolinë e madhe ovale për lexim. Në fakt nga vizita në institucion, rezultoi një bibliotekë me kapacitet pothuaj prej rreth 25 studentësh, e pajisur me një tavolinë ovale të madhe dhe me karrike përreth saj, një kompjuter dhe printer. Sipas informacionit që na u dha kishte edhe një sallë leximi, por që ishte duke u rikonstruktuar. Gjithashtu u informuam se institucioni u ofronte studentëve edhe bibliotekë on-line. Godina ka një laborator (Kabineti i Informatikës), i pajisur me një projektor dhe sipas RVB, 31

kompjutera/laptope, 1 server dhe dy printera/fotokopje. Ky laborator shërben për të gjithë programet e studimit, përfshirë edhe programin e Masterit Profesional “Menaxhim Sigurimesh”. KU “Luarasi” ka një sekretari mësimore në funksion të programit të Masterit Profesional “Menaxhim Sigurimesh”. Sipas RVB sekretaria mësimore është e pajisur me mobilimin përkatës: tavolina, karrike, kompjutera, printera. Në të kryhen procedurat administrative, mbahen regjistrat mësimore, procesverbalet etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Sipas RVB, mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione - 3
- Klasa për seminare - 3
- Salla për aktivitete promovuese - 2
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike - 1
- Salla interneti - 1
- Salla për bibliotekë - 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare - 2

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin - 2
- Zyra për sekretarinë mësimore - 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 1
- Zyra për personelin akademik - 4

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedisje janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e</p>	<p>KU “Luarasi” ka vendodhje të përhershme ku zhvillohet aktiviteti administrativ dhe mësimor.</p> <p>Godina është marrë me qera në vitin 2013 për një periudhë 20 vjecare.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në një godinë të vetme.</p>

<p>politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Për shkak se programi Masteri Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” ka vetëm një vit që është hapur, <i>ka mungesë në literaturë ndihmëse bashkëkohore.</i></p> <p>Në bibliotekë, literatura lidhur me këtë program studimi është e kufizuar. Ajo përbëhet nga ciklet e leksioneve dhe prezantime power-point, dhe disa libra të fushës përkatëse.</p> <p>Nga takimi me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, kjo mungesë tekstesh u argumentua me faktin se është viti i parë i studimit dhe nuk ekzistojnë libra në gjuhën shqipe për kurrikulën e këtij programi.</p> <p>Sipas RVB dhe informacionit që morrëm gjatë vizitave, institucioni ofronte librari elektronike për studentët e programit të MP në “Menaxhim Sigurimesh”, por kur GVJ kërkoi të aksesonte në librarinë elektronike, për shkak të problemeve teknike, nuk u mundësua.</p> <p>Sipas informacionit të marrë në takimin me Dekanin e Fakultetit Ekonomik, Institucioni u jep mundësinë pedagogëve që të blejnë libra on-line, në bazë të kërkesës së tyre. Për këtë program nuk është bërë ndonjë kërkesë nga pedagogët përkatës.</p> <p>Biblioteka ka orare të përshtatshme studimi për studentët.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të</p>	<p>Konstatimi i GVJ është se mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare.</p> <p>Institucioni ka një numër të mjaftueshëm sallash leksioni dhe seminaresh, një laborator, zyra dhe studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programeve të studentëve.</p> <p>Mjediset mësimore janë të pajisur me mjetet e nevojshme për një mësimdhënie cilësore në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>KU “Luarasi” ka një laborator të pajisur me aparaturat elektronike dhe aksesin në internet, si dhe mjetet e nevojshme për përmbushjen e punëve praktike në laborator.</p>

vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. KU “Luarasi” ka vendodhje të përhershme dhe siguron infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e programit të ciklit të dytë, Master profesional në “Menaxhim Sigurimesh”.
2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij, *por literatura në këtë bibliotekë është e pamjaftueshme për programin e Masterit Profesional “Menaxhim Sigurimesh”.*
3. KU “Luarasi” vë në dispozicion të studentëve mjedise të përshtatshme mësimore, ku përfshihet edhe një laborator informatike.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji Universitar “Luarasi” është pjesë përbërëse e shoqërisë “Panorama Grup” sh.a. Menaxhimi financiar i universitetit bëhet dhe nga Zyra e Financës së Kolegjit Universitar “Luarasi” në bashkëpunim me zyrën e financës së shoqërisë “Panorama Grup” sh.a.

Institucioni financohet nga tarifat e studentëve, pagesat e studentëve për shërbimet administrative dhe nga burime të shoqërisë “Panorama Grup” për disbalancat afatshkurtra të krijuara ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve dhe auditohet cdo vit në mënyrë të rregullt nga një ekspert kontabël i autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqëive tragtare.

Për këtë program studimi burimet e financimit janë kryesisht tarifat e studentëve dhe zënë 98.89% dhe të ardhura të tjera në masën 1.11%.

Në zërat shpenzime pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për paga. Institucioni nuk ka siguruar të ardhura nga grantet për kë PS.

Gjatë vitit akademik 2017-2018 të ardhurat mesatare për student kanë qenë 1000 euro, me të cilat kanë mbuluar shpenzimet për student që lidhen me koston e punës dhe kryesisht pagesën e pedagogëve. Pra, të ardhurat mesatare kanë mbuluar shpenzimet mesatare gjatë kësaj periudhe.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi

Këto të dhëna janë paraqitura sipas **Tabelës nr. 8 në Aneksë.**

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kosto e studimit për student për vit akademik llogaritur si raport i shpenzimeve për vit akademik dhe numrin e studentëve paraqitet sipas RVB është llogaritur 1.071 Euro.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Kolegji Universitar “Luarasi” kryen çdo vit auditimin e jashtëm të situatës financiare nga një ekspert kontabël i autorizuar konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj</p> <p>Brenda raportit të auditit janë specifikuar zërat në lidhje me grantet si dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Për këtë PS nuk janë siguruar të ardhura nga grantet dhe kontratat.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishe financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Kolegji Universitar “Luarasi” harton një raport financiar brenda afateve të përcaktuara me ligj. Në raport përfshihen pasqyrat mbi të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>Raportet financiare të tre viteve të fundit gjenden në Zyrën e Financës të Kolegjit Universitar “Luarasi”.</p> <p>Mbështetur në të dhënat financiare rezulton që të ardhurat mesatare për student janë më të larta se shpenzimet mesatare për student.</p> <p>IAL ka qëndrueshmëri financiare.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Kolegji Universitar “Luarasi” auditohet çdo vit nga një ekspert kontabël i autorizuar. 2. Kolegji Universitar “Luarasi” ka raport financiar të veçantë për këtë program studimi dhe të ardhurat mesatare mbulojnë shpenzimet mesatare. 3. Bazuar në të dhënat financiare dhe ecurinë, shprehim opinionin që IAL ka qëndrueshmëri financiare. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur me vendimin e Senatit Akademik të KU "Luarasi" Nr. 12/4, date 23.12.2016 dhe e ushtron aktivitetin e saj në bazë të neneve 14 dhe 15 të statutit të KU "Luarasi". Sipas statutit të KU "Luarasi" dhe takimit me kryetarin dhe dy anëtarë të NJBCS, ajo është përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore, kërkimore-shkencore dhe i raporton drejtëpërdrejtë rektorit. Sipas RVB, NJBSC ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të miratuar në Senatin Akademik. NJBSC ka hartuar "Planin strategjik të sigurimit, rritjes dhe përmirësimit të cilësisë" për një periudhë kohore 2016-2020, në të cilin parashikohen aktivitetet që do të realizohen nga kjo njësi, mënyra e evidentimit të tyre, periudha kohore dhe personi përgjegjës. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) përbëhet nga pesë anëtarë nga të cilët tre janë pjestarë të stafit akademik me kohë të plotë, një ekspert i jashtëm dhe një student. Në takimin me përfaqësuesit e NJBSC, GVJ u takua me tre anëtarë të saj, përfshirë edhe kryetarin.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit:

- Sa anketime kanë bërë me studentët – dy anketime në vit
- Sa studentë janë anketuar – të gjithë studentët janë ftuar, por pjesëmarrja ka qenë e ulët vecanërisht në semestrin e dytë, kur pyetsori është përgatitur on-line.
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë – Sipas RVB janë përpunuar të gjithë pyetsorët dhe nuk ka dalë ndonjë problem. Sipas Raportit të Analizës Vjetore, probleme ka patur lidhur me mungesën e teksteve në gjuhën shqipe, mungesën e bashkëpunimit me universitete të tjera, si dhe mungesën e fondeve financiare për kërkim shkencor.
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm – Problemet janë konstatuar, por për shkak të afatit të shkurtër kohor, nuk ka qenë e mundur të evidentohen hapat e mëtejshëm për zgjidhjen e problemeve.

Gjatë takimit me përfaqësues të NJBSC, GVJ u informua se realizohen dy anketine për cdo semester të vitit akademik. Semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018 është bërë edhe vlerësimi on-line nga studentët mbi cilësinë e lëndës dhe mësimdhënies nga pedagogu. Sipas takimit me NJBSC, meqënëse pjesëmarrja e studentëve në anketimin on-line ka qenë më e ulët se në anketimin e parë (i cili është realizuar me pyetsor të printuar) është vendosur që anketimi i studentëve në vazhdim të bëhet me pyetsor të printuar. Ndërsa në takimin me përfaqësues të studentëve, rezultoi se anketimi ishte bërë vetëm një here dhe on-line.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e cila ka si funksion kryesor garantimin e cilësisë, përmirësimin e vazhdueshëm të saj, në arritjen e objektivave të përcaktuara. Statuti përcakton se Senati Akademik është organi përgjegjës që garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion në përputhje me standartet shtetërore. Në nenin 74 të Statutit të KU “Luarasi” përcaktohen në mënyrë të detajuar funksionet që duhet të kryejë NJBSC.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Sipas RVB garantimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë nuk është vetëm detyrë e NJBSC, por e rëndësishme është të krijohet dhe zhvillohet kultura e cilësisë në çdo qelizë të funksionimit akademik dhe administrativ të KU “Luarasi”. Ngritja e GVB pranë Fakulteteve, përfshirja në to edhe e studentëve i shërben pikërisht këtij synimi. NJBSC monitoron dhe menaxhon profesionalisht cilësinë duke bashkëpunuar me GVB e fakulteteve. E rëndësishme është gjithëpërfshirja e palëve të interesuar në garantimin dhe rritjen e cilësisë. Sipas takimit me NJBSC, u konstatua se monitorimi dhe menaxhimi i cilësisë shkonte deri në nivel departamenti, për shkak të numrit të vogël të pedagogëve për çdo departament.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Sipas dokumentit të “Analizës Vjetore”, të kërkuar gjatë vizitave në Institucion, janë përpunuar të gjithë pyetsorët e plotësuar dhe probleme ka patur lidhur me mungesën e teksteve në gjuhën shqipe, mungesën e bashkëpunimit me universitete të tjera, si dhe mungesën e fondeve financiare për kërkim shkencor.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Për shkak të kohës së shkurtër të përpunimit të të dhënave, nuk është paraqitur informacion mbi hapat e mëtejshëm për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Gjithsesi sipas RVB, në të ardhmen NJBSC nëpërmjet GVB-ve do të realizojë ndërkohë sistematike të vazhdimësisë së programit duke patur në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumenti Nr. 5 - Raporti i Analizës Vjetore (2017-2018) i programit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”. Dokumenti Nr. 7 – Manuali i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	Referuar vizitës në KU “Luarasi” dhe takimeve në këtë institucion, GVJ konstatoi se institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit. Për këtë qëllim është ngritur NJBSC, e cila është përgjegjëse për vlerësimin periodik të veprimtarisë
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për	

arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.

Të tërthorta:

- a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;
- b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;
- e. Etj.

Të drejtpërdrejta:

- a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- h. Etj.

mësimore dhe kërkimore-shkencore.

Në bazë të dokumentacionit të marrë në institucion, GVJ konstaton se institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke ia bërë të ditur palëve të interesuara.

Institucioni informon palët e interesuara (drejtuesit e institucionit, të njëjste kryesore dhe bazë dhe pedagogët) për rezultatet e vlerësimit.

Bazuar në takimet e vizitës në institucion dhe dokumentat e vëna në dispozicion, rezulton se KU "Luarasi" përdor

metoda të tërthorta për vlerësim si:

pyetsorë të studentëve, të të diplomuarve, intervista, raporte të vlerësimit të mësimdhënies, etj.

metoda të drejtpërdrejta si:

dëgjime në auditor të paralajmëruara, rezultatet e arritura nga studentët në teste provime dhe detyra kursi, vëzhgime të kryerjes së praktikës/ushtrimeve etj.

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>KU “Luarasi”, në fund të vitit akademik përgatit dokumentin e “Analizës Vjetore”, në të cilin janë përpunuar të gjithë pyetorët e plotësuar, dhe probleme ka patur lidhur me mungesën e teksteve në gjuhën shqipe, mungesën e bashkëpunimit me universitete të tjera, si dhe mungesën e fondeve financiare për kërkim shkencor.</p> <p>KU “Luarasi” publikon rregullisht në faqe interneti dhe në media informacion mbi vlerësimin e brendshëm.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka hartuar Raportin e Analizës Vjetore (2017-2018) të programit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”, (Dokumenti Nr. 5), i cili është vënë në dispozicion pas kërkesës së bërë nga GVJ gjatë vizitave në institucion.</p> <p>Sipas RVB, në të ardhmen NJBSC nëpërmjet GVB-ve do të realizojë ndëkjken sistematike të vazhdimësisë së programit duke patur në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në përputhje me realizimin në praktikë të kritereve dhe standardeve shtetërore të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>KU “Luarasi” ka plotësuar standardet shtetërore të akreditimit institucional para akreditimit të programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”. Ai është vlerësuar maksimalisht me Vendim të Bordit të Akreditimi nr. 115, dt. 15/12/2017 dhe QA Britanike, për një periudhe 6 (gjashtë) vjeçare.</p> <p>KU “Luarasi” përdor instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë. Për këtë qëllim është ngritur dhe funksionon NJBSC, në bazë të standardeve shtetërore të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit.</p> <p>Sipas RVB, NJBSC ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të miratuar në Senatin Akademik. NJBSC ka hartuar “Planin strategjik të sigurimit, rritjes dhe përmirësimit të cilësisë” për një periudhë kohore 2016-2020, në të cilin parashikohen aktivitetet që do të realizohen nga kjo njësi, mënyra e evidentimit të tyre, periudha kohore dhe personi përgjegjës.</p>

Bar *Ole*

Konkluzionet e vlerësimit:

1. KU "Luarasi" përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë e programit të studimit. Për këtë qëllim është ngritur Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë.
2. Në bazë të "Manualit të Brendshëm të Cilësisë" dhe "Planit strategjik të sigurimit, rritjes dhe përmirësimit të cilësisë" NJBSC publikon informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm.
3. Në fund të vitit akademik, Institucioni ka kryer anallizën vjetore nëpërmjet Raportit të Analizës Vjetore (2017-2018) të programit Master Profesional në "Menaxhim Sigurimesh"

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim Sigurimesh" në Kolegjin Universitar "Luarasi" është licensuar me urdhrin Nr. 512, datë 16.10.2017. Ky program studimi ka si qëllim kryesor edukimin teorik dhe praktik në përgatitjen e specialistëve të kualifiluar në fushën e menaxhimit të shoqërive të sigurimeve, si dhe të fondeve private të pensionit, për t'i shërbyer dhe për të përmbushur nevojat e tregut të punës në mënyrën më të mirë të mundshme. Duke patur parasysh përpjekjet e mëdha për Integrimin e Shqipërisë në Europë, kërkesat e tregut të punës për specialistë të kualifikuar dhe të aftë konsiderohen të larta. Duke ndjekur këtë program studimi studentët familjarizohen me çështje të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, kapacitetet për të zhvilluar, përshtatur dhe zbatuar teknologjitë e sigurimeve në struktura ekonomike, pasi ky program është strukturuar rreth një grup lëndësh, që i ekspozon studentët me njohuritë e duhura dhe eksperiencat për të dizenuar dhe zbatuar paketa investimesh me burim fondet e sigurimeve dhe për të menaxhuar sa më mirë inovacionet dhe modelet e reja të sigurimeve. Gjithashtu, nëpërmjet bazave të aktuaristikës studentët njohin modelet statistikore të vlerësimit të risqeve në kompanitë e sigurimeve, shëndetit publik, planet e pensionit, etj, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve lidhur me tarifimin e produkteve, përcaktimin e nivelit të duhur të detyrimeve si dhe përcaktimin e nevojave për kapital për ngjarje të pasigurta në të ardhmen. Aftësitë e fituara në këtë program studimi i përgatisin studentët për të vazhduar më tej punën në institucionet publike dhe ato private. Ata mund të punësohen si drejtues, specialistë apo këshilltarë në kompani sigurime jete dhe jo jete, kompanitë e Risigurimit, fondet e menaxhimit të risqeve, fonde investimesh, AMF, AZHBR, AKBN, etj.

Objektivat e Programit Master Profesional në "Menaxhim Sigurimesh" 60 kredite janë:

1. Formimi i ekspertëve dhe specialistëve cilësorë në aspektin teorik dhe praktik;
2. Pajisja e tyre me koncepte moderne teorike dhe praktike në fushën e sigurimit të pronës, sigurimit të jetës, pensionet private, sigurimi i mjeteve motorike, etj
3. Integrimi i teorisë dhe praktikës ndërkombëtare si dhe integrimin e eksperiencës shqiptare në fushën e menaxhimit të sigurimeve dhe risigurimeve në fushat e mësipërmeduke patur në vëmendje kërkesat e reja që pasqyrojnë tregjet e vecanta, brenda cdo sistemi sigurimesh.

4. Përafrimi me standardet Europiane dhe më gjerë në zbatimin e mekanizave dhe formave të organizimit të tregut të sigurimeve, kryesisht në procesin e integruar drejt BE-së.
5. Përgatija e specialistëve në nivelin drejtues në fushën e sigurimeve sipas fushave respective

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” është program studimi me kohë të plotë. Ky program realizohet me 60 ECTS në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Administrimit Biznesit të Fakultetit Ekonomik, me vendim të Dekanatit të Fakultetit Ekonomik dhe miratuar me Vendim të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar “Luarasi”. Programi i studimit është organizuar në një vit akademik, 2 semestra dhe 15 javë mësimore për cdo semestër në auditor. Provimet e lëndëve zhvillohen në fund të cdo semestri.

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore ka 60 minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Studentët që përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara nga programi Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”, do të pajisen me diplomë **Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh”**.

Çdo lëndë ka një sasi orësh që ndahen në orë auditor dhe orë punë e pavarur që në total për të gjitha lëndët janë 1500 orë. Për vitin akademik 2017-2018 u realizuan 240 orë leksione 120 orë seminare në auditor, 50 orë praktika profesionale në auditor, 100 orë në auditor provimi përfundimtar (tema e diplomës), pra 510 orë në auditor dhe 990 orë punë e pavarur nga studenti.

Në planin mësimor në më të shumtën, modulet janë vlerësuar 5 ECTS, por ka dhe lëndë me 6 ECTS dhe si **formë mësimdhënie është parashikuar 2 orë leksion dhe 1 orë seminar.**

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Leksionet 240 orë në auditor dhe 290 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret 120 orë në auditor dhe 400 orë punë e pavarur e studentit
- Labororet N/A orë në auditor dhe N/A orë punë e pavarur e studentit
- Praktikat lëndore N/A orë në auditor dhe N/A orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 50_ orë në auditor dhe 100 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar _100_ orë në auditor dhe 200 orë punë e pavarur e studentit

Modulet në planin mësimor janë paraqitur edhe sipas veprimtarisë formuse (A-F)

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) 6 ECTS

- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B) 25 ECTS
- Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme (C) 6 ECTS
- Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D) 5 ECTS
- Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhë (E) 6 ECTS
- Teza e diplomës (F) 12 ECTS

Ndryshimet në planin mesimor, krahasuar me programin mesimor të licensuar

Plani mesimor i zhvilluar dhe realizuar krahasuar me programin mesimor të licensuar nuk ka patur ndryshime. Është bërë vetëm një ndryshim moduli, i cili nuk prek planin mesimor. Gjatë vizitës, GVJ-së iu vendos në dispozicion dokumenti i vendimit për ndryshim moduli.

Planet mesimore të lidhura me personelin akademikpërkatës

Plani mesimor i lidhur me personelin akademik përkatës ka disa ndryshime me ato të përgatitura nga GVB. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi gabime në plotësimin e tabelave dhe kërkoi përditësim të personelit akademik, të cilat iu vunë në dispozicion GVJ, por kjo nuk cënon standardin.

Vlerësimi për Syllabus-et, dhe elementët e tyre për cdo lëndë

Syllabuset janë hartuar për çdo lëndë dhe përmbajnë këto elementë bazë:

- Emërtimi i lëndës /modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Titullari dhe emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorikdhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit.
- Forma e vlerësimit të studentit
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

Analizë e cilësisë së Syllabuseve

Syllabus-et e përgatitura janë të standartizuara pothuajse në të gjitha modulet, *por mendojmë:*

Se duhet të ishin më të detajuara, ku çdo kapitull të jepte çështjet e trajtuara si dhe literaturën e mbështetur, pasi mund të gjykohet më mirë nëse lëndët kanë mbivendosje me njëra-tjetrën.

Pjesa me e madhe e syllabuseve mbështetet tek leksione të pedagogut, ku mungon literatura ku është mbështetur për përgatitjen e materialit dhe në bibliotekë leksionet ishin vetëm në format PPT.



Megjithatë, theksoj se tregu i sigurimeve është një fushë e re në vendin tonë dhe librat dhe literatura në gjuhën shqipe është ende e varfër.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Lista e plotë e lektorëve, lista e moduleve gjatë vitit akademik 2017-2018 si dhe vendimi për ndryshim moduli.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” është hapur në vitin akademik 2017-2018, në bazë të urdhërit nr. 512, datë 16.10.2017.</p> <p>Programi është organizuar në module, të cilat janë vlerësuar me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ky program përmban 60 kredite të shpërndara në 2 semestra, realizohet në gjuhën shqipe dhe zgjat një vit akademik</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të</p>	<p>Masteri profesional në “Menaxhim Sigurimesh” është një master i ri në tregun e Edukimit dhe vjen si bashkëpunim i Kolegjit Universitar “Luarasi” dhe kompanive të njohura të sigurimit si Sigal, Eurosig dhe ka si qëllim kryesor trajtimin teorik dhe praktik në përgatitjen e specialistëve të kualifikuar në fushën e menaxhimit të shoqërive të sigurimeve, fondeve private të pensionit, për t’i shërbyer dhe për të përmbushur nevojat e tregut të punës në mënyrën më të mirë të mundshme.</p> <p>Bashkërendimi në lektim i teorisë nga akademikë dhe praktikës të sjellë në seminare nga specialistët më të mirë në fushën e sigurimeve, e bën një master të vecantë profesional.</p> <p>Ky PS frekuentohej jo vetëm nga studentë që kishin background ekonomik, por edhe nga ata që punonin në kompani sigurimi dhe kishin studiuar juridik, inxhinieri, arkitekturë, ku nëpërmjet moduleve si aktuaristika, menaxhimi i risqve, sigurimi i jetës dhe pensioneve, risigurimi, fitonin aftësi teorike nga fusha e sigurimeve, e fondeve të pensionit, duke i alternuar dijet me praktikën e fitura në vendet e tyre të punës, e duke e bërë këtë një master specifik të vecantë.</p> <p>Kolegji Universitar “Luarasi” nuk ka programe të integruara të ciklit të dytë aktive.</p> <p>Qëllimi kryesor i këtij masteri është kompetenca teorike me theks kryesor praktikën duke iu përgjigjur kërkesave të tregut financiar dhe kryesisht tregut të sigurimeve.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ai i përgjigjet kërkesës për përgatitjen e specialistëve dhe menaxherëve të sigurimeve, fondeve të pensionit, një specializim që kërkohet kryesisht në sektorin privat, por dhe në Institucionet publike, AZHBR, AKBN, etj</p>

<p>qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qarta profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
--	--

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat e nivelin e dytë të studimeve.</p> <p>Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e disa elementëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rezultat e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara • Vlerësimi me pikë për aktivizimin në auditor • Vlerësimi i detyrave të kryera. • Vlerësimi për përfshirjen në aktivitete jashtë shkollore <p>Vlerësimet bëhen në procesverbale dhe dorëzohen në sekretari.</p>
---	--

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimin në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Ky PS është i ri në vendin tonë dhe hartimi i tij është mbështetur në ekseriencën e vendeve të zhvilluara. Programi është mbështetur në një program të ngjashëm të Universitetit të Parmës në Itali, duke reflektuar dhe nevojat e tregut vendas të pasqyruara nga kompanitë e sigurimit, me të cilat bashkëpunon për këtë PS Kolegji Universitar “Luarasi”.</p> <p>Programi MP në Menaxhim Sigurimesh është ende në vitin e parë të funksionimit të tij dhe nuk ka patur bashkëpunim konkret me universitete të huaja.</p> <p>Programi është në harmonizim të plotë me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
---	--

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p>Ky PS është i orientuar kryesisht drejt aftësimin profesional të studentëve dhe me pak atij shkencor, për nga vetë natyra dhe qëllimi i këtij masteri, i konceptuar si bashkëpunim i Kolegjit Universitar “Luarasi” dhe Kompanive të sigurimit, për t’iu</p>
---	---

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>përgjigjur kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Programi Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” është licensuar si program studimi i ciklit të dytë, me urdhër të MASR, nr. 512, datë 16.10.2017, lëshuar në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 35, pika 1 e ligjit nr. 80/2015 për “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Kolegji Universitar Luarasi organizon aktivitete ndërkombëtare shkencore të përvitshme me tematika aktuale, ku zënë një peshë të konsiderueshme punimet shkencore të stafit të tij akademik.</p> <p>GVJ gjatë vizitës konstatoi se në konferencën e Prillit të vitit 2018, një pjesë e konsiderueshme e punimeve lidheshin me tregun e sigurimeve dhe sfidat e zhvillimit të tij, që dëshmon për angazhimin e stafit akademik në punë kërkimore për të arritur qëllimet dhe objektivat e këtij PS.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Me zhvillimin e vazhdueshëm të tregut të punës, konkurrenca do të bëhet edhe më intensive. Ky PS siguron zhvillimin e aftësive teoriko-praktike, të komunikojnë qartë, të kuptojnë dimensionet e vendimeve që ata marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që ka menaxhimi i kompanive të sigurimit, fondeve të pensionit për ekonominë dhe shoqërinë, për të qenë të suksesshëm në punësim në tregun vendas apo të huaj.</p> <p>Sipas të dhënave për punësimin e studentëve për periudhën 2017-2018, nga 44 studentë që ndjekin këtë program studimi, 42 janë të punësuar, në kompani sigurimi përpara fillimit të këtij PS.</p> <p>Kolegji Universitar “Luarasi” ka vlerësuar nevojat e tregut të punës nëpërmjet një studimi tregu në shtator të 2018, dokument që iu vendos në dispozicion GVJ gjatë vizitës në institucion.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; 	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ai i përgjigjet kërkesës për përgatitjen e menaxherëve të sigurimeve, një specializim që kërkohet kryesisht në sektorin privat të sigurimeve dhe fondeve të pensionit, por dhe në institucionet publike.</p> <p>Programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit, nevojat për përgatitjen e specialistëve të aftë për të punuar për industrinë e sigurimeve.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ iu vendos në dispozicion dokumenti mbi studimin e tregut të punës.</p>

d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar “Luarasi” dhe politikat e ndjekura janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare mbi arsimin e lartë të MASR.</p> <p>Programi Master është ndërtuar që t’i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian.</p> <p>Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” përmban 60 kredite ETCS, të shpërndara në 2 semestra, realizohet në gjuhën shqipe dhe zgjat një vit akademik.</p>
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p><i>Në faqen e web-it të Institucionit nuk ka informacion për syllabuset e këtij program studimi.</i></p> <p>Informacioni jepet gjatë fillimit të semestrit nga pedagogët përkatës.</p>
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Rregullorja e diplomimit hartohet në përputhje me Ligjin për IAL-të, me statutin dhe rregulloren e Kolegjit Universitar “Luarasi” dhe parashikohet plani i diplomimit sipas kalendarit akademik. Megjithatë, në rregulloren e diplomimit, neni 3, nuk është pasqyruar ETCS që duhet të ketë studenti në masterin me 60 kredite. Studenti nuk diplomohet nëse kalon afatin kohor 3 vite nga koha e mbarimit të studimeve të plota ose nëse nuk ka kaluar provimin e diplomës për herë të katërt.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>1. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” përputhet me strategjinë për zhvillim të Institucionit dhe është hartuar në përputhje me strategjinë afatmesme për zhvillimin e tij.</p>	

2. Në hartimin dhe zbatimin e këtij Programi janë mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe parakushteve të rrjedhura nga Ligji I Arsimit të lartë dhe Udhëzimet përkatëse të MASR.
3. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimet përkatëse të MASR.
4. Programi i studimit përfshin aftësim profesional dhe më pak shkencor, për nga vetë natyra specifike e këtij masteri.
5. Programi i studimit ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës.
6. *Duhet të rritet efikasiteti i informacionit lidhur me PS. Institucioni duhet të publikojë në web-in e saj informacion për programet e studimit.*
7. Ky PS parashikon planin ligjor të diplomimit sipas kalendarit akademik

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Sipas RVB, mësimdhënia është organizuar në bazë të planit strategjik dhe rregullores së KU "Luarasi". Procesi mësimor zhvillohet në dy semestra dhe realizohet nëpërmjet leksioneve, seminareve, projekteve/detyrave të kursit, laboratorëve në varësi të lëndës, si dhe punë të pavarur të studentëve që kontrollohen nda pedagogu i lëndës.

Materialet e leksioneve janë të depozituara në Bibliotekë dhe u dërgohen studentëve on-line nga pedagogu i lëndës. Programi mësimor sipas RVB është i publikuar në faqen e web të Kolegjit.

GVJ konstatoi se programi nuk është i publikuar në faqen e web-it, sepse sipas informacionit të marrë nga përfaqësues të institucionit, faqja e internetit është duke u rikonstruktuar.

Sipas syllabuseve të lëndës, kontrolli i njohurive të studentëve bëhet në mënyrë uniforme për të gjitha lëndët e programit Master Profesional në "Menaxhim Sigurimesh".

Vlerësimi i mësimdhënies bëhet edhe nga studentët nëpërmjet plotësimit të një pyetsori për pedagogët, si edhe nga Njësia e Brendshme e Kontrollit dhe Cilësisë nëpërmjet kontrolleve dhe vizitave gjatë procesit mësimor. Vlerësimi i studentëve bëhet në bazë të syllabuseve të miratuara në cdo lëndë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:**

Format kryesore të mësimdhënies janë

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale

Format e kontrollit të njohurive

Kontrolli i dijeve të studentëve bëhej në bazë të pjesëmarrjes dhe angazhimit të tyre në seminare, realizimin e projekteve/detyrave të kursit, testimeve gjatë vitit dhe provimit përfundimtar. Format e kontrollit të dijeve të studentëve paraqiten në syllabuset e cdo lënde.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Sipas RVB dhe takimeve me përfaqësues të institucionit, rezultoi se studentët e këtij programi nuk janë përfshirë në aktivitete dhe kërkime shkencore, për arsye se ishte viti i parë i studimit të programit dhe pjesa më e madhe e studentëve ishin në marrëdhënie pune.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Kolegji Universitar “Luarasi” ka miratuar procedurat e Pranimit për studentët në këtë PS. Kriteret kalasifikohen si kriteret të përgjithshme dhe kriteret specifike për shtetasit e huaj. Në Programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Sigurimesh” kanë të drejtë për t’u pranuar:

- Shtetasit shqiptarë që vërtetojnë përfundimin me sukses të shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë saj të ekuivalentuar sipas kriterëve të MASR.
- Shtetasit shqiptarë që zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të parë “bachelor” së bashku me listën e notave dhe suplementin e diplomës ose disponojnë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, vërtetimin e njësimi të kësaj diplome lëshuar nga MASR.
- Pranojnë pagimin e tarifës së shkollimit.

Shtetasit e huaj duhet të kenë:

- Kopjen e noterizuar të lejes së qëndrimit brenda 3 muajve nga data e aplikimit
- Deshmia e njohjes së gjuhës shqipe të lëshuar nga fakulteti i Histori- Filologjisë në UT

Studentët që plotësojnë kriteret rregjistrohen nga IAL sipas Udhëzimit Nr. 17, datë 31.07.2012 “Për procedurën e pranimit dhe rregjistrimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve me kohë të plotë të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë Privat, si dhe për transferimin e studimeve për vitet akademike respective. Studentët që plotësojnë kriteret e pranimit mund të rregjistrohen dhe të lidhin kontratën e rregjistrimit, pasi studenti ka dorëzuar dokumentacionin që kërkohet sipas udhëzimit. Kriteret e pranimit shpallen edhe online në website-in e institucionit.

Sipas programit të ciklit të dytë të studimeve të Masterit Profesional “Manaxhim Sigurimesh” (Dokument nr.13, i vendosur në dispozicion nga GVB), pika 12, pranohen vetëm studentë me diploma bachelor nga Fakulteti Ekonomik dhe i Drejtësisë. Ndërkohë gjatë vizitës që patëm me student të këtij masteri u konstatua se në këtë program janë rregjistruar edhe student me diplomë bachelor nga fakultete të tjera.

Numri i studentëve të pranuar në këtë program studimi në vitin akademik 2017 – 2018 është 44 studentë,(3 studentë janë larguar), nga 51 aplikantë. Nota mesatare e pranimit është 6.9.

Nga 44 studentë që vazhduan studimet vetëm 16 prej tyre përfunduan provimin e diplomimit.

Ky është një master i ri dhe është vetëm në vitin e parë të aktivitetit të tij.

Kolegji Universitar “Luarasi” ka themeluar Qendrën e Planifikimit të Karrierës, e cila e kryen veprimtarinë e saj në kuadër të zyrës së planifikimit të karrierës dhe studentëve të Diplomuar. Qendra orienton studentët në procesin e zhvillimit të ardhshëm dhe ndërmjetëson komunikimin ndërmjet studentëve dhe institucioneve apo kompanive të ndryshme me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar.

Ky PS është specific sepse pothuajse të gjithë studentët janë të punësuar në kompani sigurimi, pasi sikurse kemi theksuar ky është një master produkt i bashkëpunimit të kompanive të sigurimit dhe Kolegjit Universitar “Luarasi”. Ndër fushat kryesore të saj është dhe organizimi i programeve të praktikës si dhe organizimi i trajnimeve për studentët e kolegjit Universitar “Luarasi”, për t’i pajisur ata më mirë me aftësitë e nevojshme që do t’i ndihmojnë në karrierën e ardhshme profesionale.

Kolegji Universitar “Luarasi” është duke krijuar databazë të Diplomuarve (Alumni), duke filluar nga viti 2018- 2013, e cila kërkon të zgjojë interesin dhe pjesëmarrjen e të diplomuarve në jetën e Universitetit, por ende nuk ka një rrjet të mirë të gjurmimit të studentëve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të</p>	<p>Studentët në PS “Master professional” zotërojnë diplomën universitare “bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite.</p> <p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Sipas programit të ciklit të dytë të studimeve Masteri Profesional në “Menaxhim Sigurimnesh”, pranohen vetem studentë me diploma bachelor nga Fakulteti Ekonomik dhe i Drejtësisë. Ndërkohë në këtë program janë rregjistruar edhe studentë me diplomë bachelor nga fakultete të tjera, që bie në kundërshtim me kriteret e vendosura në PS.</i></p> <p>Studentët do të diplomohen pasi të kenë paraqitur certifikatën e gjuhës së huaj sipas udhëzimit 52, dt - 3.05.2005</p> <p>Ky është Program i ri dhe ka vetëm një vit që është aktivizuar, megjithatë gjatë vizitës në institucion u konstatua se Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programet e studimit.</p>

pranimi.	
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Kolegji Universitar “Luarasi” ka themeluar Qendrën e Planifikimit të Karrierës, e cila kryen veprimtarinë e saj në kuadër të zyrës së planifikimit të karrierës dhe studentëve të Diplomuar. Qendra orienton studentët në procesin e zhvillimit të ardhshëm dhe ndërmjetëson komunikimin ndërmjet studentëve dhe institucioneve apo kompanive të ndryshme me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar.</p> <p>Ky PS është specifik se pothuajse të gjithë studentët janë të punësuar në kompani sigurimi, pasi sikurse kemi theksuar ky është një master produkt bashkëpunimit të kompanive të sigurimit dhe Kolegjit Universitar “Luarasi”.</p> <p>Personeli akademik dhe Sekretaria mësimore njofton në mënyrë të vazhdueshme studentët për programin e studimit, akreditimin ose jo të tij që në momentin e regjistrimit.</p> <p>Gjithashtu informacioni publikohet dhe në website-in e institucionit.</p> <p>Qendra e Planifikimit të Karrierës ka si fushë kryesore të saj dhe organizimin e programeve të praktikës si dhe organizimi i trajnimeve për studentët e kolegjit Universitar “Luarasi”, për t’i pajisur ata më mirë me aftësitë e nevojshme që do t’i ndihmojnë në karrierën e ardhshme profesionale. Zyra është e hapur çdo ditë nga ora 14:00 – 16:00.</p>
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>PS Master në “Menaxhim Sigurimesh” është master i ri dhe ka vetëm 1 vit që është aktivizuar. Sekretaria mësimore disponon të dhëna statistikore për numrin e studentëve që janë regjistruar dhe larguar në bazë viti akademik.</p> <p>Numri i studentëve që kanë përfunduar provimin e diplomimit është 16 nga 44 të regjistruar.</p> <p>Sekretaria mësimore disponon statistika vjetore që nevojiten për përmbushjen e këtij kriteri. Sistemi i Informacionit për çështjet e studentëve ka të dhëna dhe gjeneron raporte statistikore për të gjithë kategoritë e studentëve.</p> <p>Për këtë PS janë larguar 3 studentë, nga 44 të regjistruar.</p> <p>Sekretaria mësimore si dhe sekretaria e departamenteve disponojnë të dhëna të ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të çdo student gjatë zhvillimit të programit mësimor (notat e</p>

	provimeve, frekuentimin, etj). Të dhënat ruhen në rregjistra.
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Pothuajse të gjithë studentët në këtë master janë të punësuar në kompani sigurimesh.</p> <p>Ky është një master i ri dhe institucioni nuk disponon të dhëna.</p>
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore dhe personeli akademik informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.</p> <p>Studentët përpara se të futen në provimin përfundimtar njoftohen me të gjitha pikët e mara sipas syllabusit.</p> <p>Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se studentët kishin mundësitë të komunikonin me përgjegjësin e modulit për çdo paqartësi apo ankesë që mund të kishin në lidhje me provimin.</p>
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës iu ofron shërbimin e këshillimit studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon në trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>Në këtë program studimi të gjithë studentët janë të punësuar në kompani sigurimi.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Pranimi në programin e studimit bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. 2. Kolegji Universitar "Luarasi" përcakton kriteret të përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve në programin e studimit Master profesional në "Menaxhim Sigurimesh" sipas rregullave në fuqi. Në këtë program janë rregjistruar edhe studentë me diplomë bachelor nga fakultete të tjera, gjë që bie në kundërshtim me kriteret e vendosura në PS. 3. IAL i informonte studentët në lidhje me programin e studimit që ofron dhe me politika e punësimit të studentëve. Në këtë PS studentët janë të punësuar në kompani sigurimesh. 4. IAL disponon statistika për numrin e studentëve që ndjekin këtë PS. 	

5. Studentëve iu ofrohet shërbimi i Këshillimit të Karrierës.
6. IAL disponon të dhëna të ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme të çdo studenti gjatë zhvillimit të programit mësimor. Të dhënat ruhen në rregjistra.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Në bazë të neneve 71 dhe 72 të Statutit të KU “Luarasi”, politika e kërkimit shkencor kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke integruar veprimtarinë kërkimore me atë të mësimdhënies. Sipas RVB, politikat e kërkimit shkencor kanë për qëllim të rritin performancën shkencore të stafit akademik me dimensionet bashkëkohore dhe nivelin kërkimor europian; të reflektojnë këtë performancë shkencore në auditore dhe punën interaktive me studentët; të krijojnë marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare, për hulumtime shkencore të përbashkëta në fushën e ekonomisë dhe financës; të gjenerojnë kërkim shkencor, nëpërmjet organizimit apo pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të stafit akademik, botimit të revistës periodike të KU “Luarasi”, bashkëpunimit me lektorë të shquar vëndas dhe të huaj për trajtimin e çështjeve aktuale të ekonomisë; të realizojë marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë për trajnimin dhe kualifikimin e stafit akademik.

Kërkimi shkencor në KU “Luarasi” zhvillohet në tre nivele:

Në nivel departamenti, i cili bëhet iniciator i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme shkencore;



Në nivel institucioni duke bashkëpunuar me institucione të ndryshme me të cilat ndan të njëjtat vlera dhe synime;

Si edhe punë kërkimore individuale e pedagogëve të KU “Luarasi.”

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Kërkimi shkencor në KU “Luarasi” lidhet me organizimin e dy konferencave shkencore ndërkombëtare. Konferenca e parë është organizuar në 12 prill 2017 më temë “Inovacioni dhe zhvillimi i qëndrueshëm” dhe e dyta në bashkëpunim me Qendrën FAB, në datë 24 Maj 2018 me temë “Dinamizmi i Reformave dhe Ndikimi i tyre në Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik, Politik dhe Social”. Në këto konferenca patën mundësi të merrnin pjesë të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme të KU “Luarasi”. Personeli akademik për programin mësimor Master Profesional “Menaxhim Sigurimesh” ka marrë pjese me disa artikuj shkencorë në konferencën “Dinamizmi i Reformave dhe Ndikimi i tyre në Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik, Politik dhe Social”. KU “Luarasi” organizon leksione të hapura me studentët, duke ftuar pedagogë dhe personalitete të huaj ose shqiptarë. Gjithashtu KU “Luarasi” boton edhe një revistë shkencore “Mendimi”. Sipas raportit të aktiviteteve, në Fakultetin e Ekonomisë, gjatë vitit akademik 2018-2018 është zhvilluar një leksion i hapur me lector vendas.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL –53 (Sipas RVB)
- Numri i projekteve kërkimore të fituara – **nuk ka**
- Numri i projekteve të zbatuara – **nuk ka**
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL – 2 (Sipas RVB)
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL – 112 (Sipas RVB)
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor – **nuk ka**
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor – **nuk ka**
- Numri i Çmimeve Kombëtare – **nuk ka**

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumenti nr. 9 “Kalendari i aktiviteteve”

Dokumenti nr. 10 “Raporti i aktiviteteve”

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe nga vizitat në institucion e GVJ në institucion, u konstatua se personeli akademik i programit të masterit profesional në “Menaxhim Sigurimesh” publikon artikuj dhe materiale shkencore në revista të ndryshme dhe merr pjesë në konferenca shkencore.</p> <p>Nëpërmjet angazhimit në veprimtari shkencore, personeli akademik jep kontributin e tij shkencor në fushën e financës dhe në vecanti atë të sigurimeve.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master Profesioanal në Menaxhim Sigurimeshe zhvillon procesin mësimor në gjuhën shqipe.</p> <p>Departamenti nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë</p>	<p>Institucioni angazhohet në kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik nëpërmjet organizimit të konferencave, botimit të revistës së KU “Luarasi”.</p> <p>Gjatë takimit me Dekanin e Fakultetit Ekonomik,</p>

<p>e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>rezultoi se institucioni akordon një fond të vecantë për kualifikimin e mëtejshëm të pedagogëve të institucionit. Deri tani Institucioni sipas RVB nuk i ka ofruar personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve jashtë vendit, por brenda vendit e ka ofruar nëpërmjet organizimit të konferencave dhe revistës.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitave në institucion, GVJ konstatoi se KU “Luarasi” disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik, të angazhuar në këtë program, e hartuar në bazë të deklarimeve personale.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitave në institucion, GVJ konstatoi se KU “Luarasi” disponon një bazë të dhënash lidhur me kualifikimin shkencor të stafit akademik, të përfshira në dosjet e personelit.</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë, kishte kryesisht materiale në power-point, dhe shumë pak libra.</p> <p>Sipas RVB, KU “Luarasi” nuk disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programin e masterit profesional “Menaxhim në Sigurimesh”.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit. 2. KU “Luarasi” mundëson kualifikimin shkencor të personelit akademik nëpërmjet organizimit të konferencave shkencore dhe botimit të revistës së Institucionit. 3. KU “Luarasi” disponon të dhëna lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik, të paraqitura në dosjet personale të tyre. 	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar “Luarasi” ka në strukturën e tij zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë, që synon marrëveshje bashkëpunimi dhe/ose protokolle me IAL dhe Institucione kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Por, informacioni i marrë nga faqja zyrtare është i përgjithshëm dhe mungon informacion i detajuar për numrin e projekteve dhe bashkëpunimeve.

Kolegji Universitar “Luarasi” ka ndërtuar partneritete të qëndrueshme me komunitetin e biznesit. Qëllimi i këtyre partneriteteve është të mundësojnë realizimin e praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre bizneseve. Programi i studimit Master profesional në “Menaxhim Sgurimesh” është një program i ri studimi me vetëm një vit aktivizim. Për këtë program studimi janë nënshkruar 3 marrëveshje bashkëpunimi konkretisht; Autoritetin e mbikqyrjes financiare, SIGAL dhe EUROSIG, për të përmbushur qëllimin kryesor të këtij PS, ku ndërthuren konceptet teorike me përvojën dhe praktikën në fushën e sigurimeve, fondeve private të pensionit, duke kontribuar në formimin profesional të studentëve. Gjatë vizitës në IAL u konstatua që të dhënat e deklaruara nga RVB për marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset dhe AMF janë korrekte dhe nuk ka ndryshime.

Të dhënat sasiore për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar:

1. Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare (0)
2. Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj për vitin akademik 2017-2018 (2)
3. Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit (0)
4. Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL për vitin akademik 2017-2018 (0)
5. Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor (-)
6. Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime (-)

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese; Autoriteti i mbikqyrjes financiare
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës; Shoqëria e Suigurimit “Eurosig” sha, Shoqëria “Insig sha

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Aktualisht Kolegji Universitar Luarasi për këtë PS ka 3 Marrëveshje bashkëpunimi. Dy me kompanitë e sigurimit INSIG dhe Eurosig si dhe marrëveshje bashkëpunimi me AMF. Këto marrëveshje ndihmojnë IAL për të arritur objektivat në këtë PS.</p> <p>Ky PS është i vecantë pasi është krijuar si një bashkëpunim i Kolegjit Universitar “Luarasi” dhe kompanive të sigurimit, ku koordinohet mësimdhënia nga Ekspertë dhe profesionistë më të mirë të fushës së sigurimeve, duke i orientuar studentët drejt problematikave aktuale dhe sfidave që paraqet tregu i sigurimeve, me synim përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	

[Handwritten signatures and initials]

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Kolegji Universitar “Luarasi” ka nxitur bashkëpunimin e efektshëm ndërmjet personelit mësimdhënës dhe atij administrativ. Gjatë vizitës u konstatua një klimë pozitive, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ndërmjet personelit të Departamentit të Administrim Biznesit dhe stafit mbështetës.</p> <p>Kolegji Universitar “Luarasi: ka ndarje të qartë të detyrave sipas vendeve të punës dhe përshkrimi i punës orienton secilin punonjës të që të kryejë detyrat që i takojnë.</p>
--	---

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Ky është një program i ri studimi, dhe aktualisht IAL nuk ka Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja. Por, për PS, IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani sigurimi dhe me AMF. Shumë nga këto marrëveshje ndihmojnë IAL për të arritur objektivat në këtë PS.</p> <p>Këto marrëveshje bashkëpunimi synojnë në kryerjen dhe mbikëqyrjen profesionale. Në këtë PS pothuajse të gjithë studentët janë të punësuar në kompani sigurimi.</p> <p>Nga RVB dhe nga vizita në IAL nuk konstatuam që të organizohen trajnime të mtejshme profesionale me studentët e këtij PS, pasi pothuajse pjesa me e madhe punon në kompani sigurimi.</p> <p>Ky PS ka vetëm një vit akademik dhe janë nënshkruar 3 marrëveshje bashkëpunimi.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Nga takimi i organizuar me stafin me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme u konstatua se klima e punës në IAL ishte bashkëpunuese dhe mbështetëse.
2. Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me kompanitë e sigurimit dhe ende nuk ka bashkëpunime me institucionet e tjera homologe, brenda dhe jashtë vendit.
3. IAL ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Institucione si AMF, dhe kompanitë e sigurimit INSIG dhe Eurosig, që mundësojnë kryerjen e praktikave të studentëve. Në këtë PS pothuajse të gjithë studentët punojnë në kompani sigurimi.

I. ANALIZA PËRMbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Programi i vetëm i mirëfilltë mësimor i ciklit të dytë që ofron një diplomë në fushën e sigurimeve.

- 2) Marrëveshje bashkëpunimi me shoqëritë e sigurimeve dhe Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare.
- 3) Infrastruktura e përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore.

b. Pika të dobëta:

- 1) Literatura lidhur me këtë program studimi është e kufizuar, kryesisht në formën e leksioneve power-point.
- 2) Mungesa e projekteve kërkimore-shkencore të fituara dhe të zbatuara nga ana e institucionit.
- 3) Ky program mbulohet nga pedagogë efektivë në masën 61%.
- 4) Informacioni për këtë PS nuk ofrohet on-line, në faqen e internetit të Institucionit.

c. Mundësitë:

- 1) Bashkëpunimi edhe me universitete të huaja dhe vendase për përmirësimin e literaturës dhe procesit mesimor.
- 2) Akordimi i një fondi të vecantë për blerjen e literaturës si dhe aksesin në bibliotekë elektronike.
- 3) Rritja e interesit të shoqërisë në të mësuarin e vazhdueshëm
- 4) Përmirësimi i imazhit të Universitetit me orientim kërkimi.
- 5) Marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL të huja për kualifikimin e stafit

d. Pengesat:

- 1) Kohëzgjatja e shkurtër (vetëm një vit) nuk ka dhënë mundësi për përmirësime të mëtejshme të programit.
- 2) Mungesa e projekteve të fituara nga institucioni, pengon kualifikimin e stafit akademik.
- 3) Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor i Arsimit të Lartë
- 4) Konkurenca jo e drejtë e Arsimit të lartë në Shqipëri.

II. SUMMARY ANALYSIS FOR THE IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAM

a. Strengths:

- 1) The only genuine curriculum of the second cycle that offers a degree in insurance.
- 2) Cooperation agreements with insurance companies and the financial supervisory authorities.
- 3) Suitable infrastructure for teaching and scientific researches activities.

b. Weaknesses:

- 1) Limited literature in Albanian and foreign languages. It is mainly in the form of power-point lectures.
- 2) Lack of research projects by the institution.
- 3) This program is covered by 61% of effective professors.
- 4) Information about this SP is not provided on-line, on the Institution's website.

c. Opportunities:


- 1) Collaboration with foreign and local universities to improve literature and teaching process.
- 2) Allocating a special fund for purchasing of studying materials and accessing the electronic libraries.
- 3) Increasing the company's interest in continuing learning.
- 4) Improving the image of the University through research orientation.
- 5) Cooperation agreements with foreign institutions for the qualification of the staff.

d. Threats:

- 1) The short duration (only one year) has not provided the opportunity for further improvement of the program.
- 2) Lack of projects undertaken by the institution, hampers the qualification of the academic staff.
- 3) Continuous change of the legal and sub-legal framework of Higher Education.
- 4) Unfair Competition of Higher Education in Albania.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Brunilda Duraj



Prof.Asoc. Gentiana Sharku

